



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ

ADGJTHFR.nr.7/24

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, kryetari i gjykatës Mustaf Tahiri, duke vendosur në çështjen disiplinore, sipas ankesës për iniciimin e procedurës disiplinore të parashtruar nga pala ankuese Nj.H., me pretendimin për shkelje disiplinore nga gjyqtari i Gjykatës Themelore në Ferizaj H.Z., në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 3 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, më 04.07.2024, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj H.Z., e paraqitur nga pala ankuese Nj.H., për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore në çështjen civile C.nr.1701/20.

A r s y e t i m i

Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj si autoritet kompetent, më 24 qershor 2024, përmes aktit përcjellës nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, ka pranuar kërkesën e palës Nj.H., e cila është trajtuar si ankesë e paraqitur kundër gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Ferizaj H.Z., me pretendimin për shkelje ligjore dhe shkelje disiplinore.

Ankuesi, në kërkesën/ankesën e tij ka theksuar se “lëndën e ka tek gjyqtari H.Z., dhe se gjyqtari lëndën e ka dërguar tek Përmbaruesi privat E.M., por përmbaruesi pasi që ka pranuar lëndën ka kërkuar 100 euro, mirëpo i njëjti kurrë nuk është marrë me lëndën dhe as nuk e hap telefonin, në

zyrë nuk e hap derën, i kam treguar gjyqtarit, gjyqtari më ka thënë se nuk ke punë me mua. Unë kam mbet pa para, pa veturë, mashtruesi Q.Rr. ka ikur në Zvicër, dhe më ka thënë se *“kurrë paret me sy nuk ke me i pa, shko te gjyqtari merri se gjykata ti paguan”*. I njëjti ka theksuar se kërkon nga KGJK që të merret me gjyqtarin H.Z., dhe të merr masa ndaj Q.Rr., të njëjtin ta kthejnë në Kosovë sepse është vendas i mashtruesit dhe unë jam nga Mitrovica. I njëjti ka theksuar se Q.Rr. sa kishte qenë në burg më ka treguar një polic A.B, se i babai i tij e ka kërkuar prokurorin mu taku për të, dhe se Q.Rr. kanë pasur me liru që një javë, por ja kanë vazhduar paraburgimin, dhe polici është takuar me prokurorin dhe e kanë liru, se kta janë milionera, po dyshoj mos e kanë mashtruar përmes dikujt. Babai i Q. më ka thënë se pasurinë e kanë bashkë, me shpija janë të ndarë, dhe se pagesën S. ja ban se aj vetët, kta i korruptojn krejt i kan milionat”.

Një kërkesë të përafërt me atë theksuar më lartë, gjykata e ka pranuar me datë 21.02.2023, dhe Kryetari i Gjykatës, ashtu siç është udhëzuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, e ka trajtuar të njëjtën, ku edhe i ka kthyer përgjigje me shkrim palës, dhe e ka njoftuar po ashtu KGJK-në dhe ankuesin me shkrim në lidhje me këtë përgjigje.¹

Gjyqtari H.Z., në deklaratën e tij me shkrim lidhur me pretendimet e palës ankuese, ka theksuar se lidhur me këtë çështje, me datë 02.03.2023 kam paraqitur në mënyrë kronologjike rrjedhën e procedurës kontestimore për të cilën pala ka qenë në cilësi të palës paditëse, andaj i gjithë deklarami im në lidhje me këtë çështje gjendet në vijim të deklaratës, ndërsa i njëjti me datë 02.03.2023 kishte deklaruar se *“me datë 05.11.2020, personi në fjalë pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj kishte paraqitur padi për kompensimin e dëmit. Lidhur me këtë gjykata (gjyqtari i çështjes) pa caktuar seancën përgatitore apo kryesore, konform nenit 150 të LPK-së me aktgjykimin C.nr.1701/20 të datës 20 prill 2021, e ka aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit (ankuesit) për shkak të mos bindjes së të paditurit Q.Rr. dhe se lënda është përcjellë në shkrimoren civile”*. Për më tepër të gjitha shkresat e lëndës duke përfshirë edhe aktgjykimin gjenden në sistemin SMIL, sipas numrit të lëndës 2020:151430.

Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, si autoritet kompetent pas shqyrtimit dhe vlerësimit të pretendimeve të palës ankuese, vlerësimit të deklaratës së gjyqtarit H.Z., si dhe shkresave tjera që

¹ Përgjigja GJA.nr.98/2023 datë 06.03.2023, drejtuar KGJK-së dhe ankuesit

ka bashkangjitur pala ankuese, dhe shkresave të lëndës C.nr.1701/20 ka ardhur në përfundim se nuk ka bazë të arsyeshme për shkelje disiplinore nga gjyqtari H.Z.

Nga shkresat e lëndës C.nr.1701/20 konstatohet se Gjykata Themelore në Ferizaj me datë 04.11.2020 ka pranuar padinë e paraqitur nga paditësi Nj.H. nga Mitrovica, me të cilën është i paditur Q.Rr. nga fshati ..., komuna Ferizaj, me bazë juridike Kompensim dëmi vlera e kontestit 2,500 euro, dhe si prova janë bashkangjitur kopja e autorizimit dt.21.06.2018, kopja e aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.1119/18 dt.08.07.2020 dhe paditësi i ka propozuar gjykatës që padia të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe të detyrohet i padituri Q.Rr. që t'ia kompensoj shumën në vlerë prej 2500 euro në emër të detyrimit për pagesën e automjetit Audi, tipi B5, numër regjistrimi 02-..., në afat prej 15 ditësh nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë. Me aktvendimin C.nr.1701/20 të datës 20.11.2020, gjykata e ka obliguar të paditurin Q.Rr. që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të padisë së bashku me shkresat e lëndës, të cilat i ka bashkangjitur aktvendimit, ti paraqes gjykatës përgjigje me shkrim në padi.

Gjykata, përkatësisht gjyqtari H.Z. konform dispozitës së nenit 150 par.1 të LPK-së, për shkak të mosbindjes/pa dëgjueshmërisë ka marr aktgjykim C.nr.1701/20 të datës 29.04.2021, dhe ka aprovuar padinë e paditësit Nj.H. nga fshati, komuna Mitrovicë dhe ka detyruar të paditurin Q.Rr. nga fshati ... që paditësit në emër të kompensimit të dëmit ti paguaj shumën prej 2500 euro si dhe shpenzimet procedurale, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, i cili aktgjykim ka marrë datën e plotfuqishmërisë me 27.05.2021.

Andaj, duke pasur parasysh që kjo lëndë në gjykatë është e përfunduar dhe Aktgjykimi C.nr.1701/20 i datës 29.04.2021 është bërë i plotfuqishëm me 27.05.2021, dhe gjykata ka aprovuar në tërësi kërkesën e paditësit si në kërkesëpadinë e tij, dhe bazuar në theksimet e parashtruesit të kërkesës, dhe ashtu edhe siç kuptohet nga përmbajtja e kërkesës kjo çështje tani është fazën e procedurës së përmbarrimit tek përmbarruesi privat, dhe të gjitha procedurat ligjore lidhur me përmbarrimin e aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm divizioni civil C.nr.1701/20 i datës 29.04.2021, i plotfuqishëm me datë 27.05.2021, tani janë në kompetencë të përmbarruesit privat, dhe çdo kërkesë në drejtim të përmbarrimit të kësaj lëndë duhet ti drejtohet përmbarruesit privat, ku edhe është theksuar dhe përmendur edhe në kërkesën e palës drejtuar në KGJK, sepse gjykata përkatësisht gjyqtari H.Z., ka përfunduar me kohë procedurën duke vendosur

në kërkesëpadinë e paditësit Nj.H., dhe më nuk ka në kompetencë veprime tjera në drejtim të përmbartimit ashtu siç ka kërkuar ankuesi, e aq më pak të ketë ndërmarrë ndonjë veprim, apo sjellje që do të konsiderohej si shkelje disiplinore nga ana e gjyqtarit.

Andaj, bazuar në nenin 9 paragrafi 6 të Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, si dhe nenit 6, 7 paragrafi 1 dhe 3 pika 3.2 të Rregullores nr.05/19 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore, nuk mbështetet në fakte dhe prova mbi të cilat do të ngritët eventualisht dyshimi mbi shkelje të supozuar disiplinore ndaj gjyqtari H.Z., andaj si e tillë refuzohet si e pa bazuar.

Nga arsyet e shpjeguara më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

AD/GJTHFR.7/2024

4 korrik 2024

Mustaf TAHIRI

Kryetar i Gjykatës

Iu dërgohet:

Nj.H. - Parashtrues i ankesës

H.Z. - Gjyqtar

Këshillit Gjyqësor të Kosovës